

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NE PEJË, duke vendosur ne procedurë kundërvajtëse kundër të pandehurit: Milazim Shatri nga fsh.Tomoc, K-Istog, për kundërvajtje nga neni 6 par.1 pika 1.2 dhe nenit 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-150, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të neneve 30, 74, 123, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt.08.10.2012, bie këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Milazim (Mustafë) Shatri, i lindur më datë 24.06.1962, nga fsh.Tomoc, K-Istog, me profesion Ing.i Bujqësisë, Kryeshf Ekzekutiv pranë KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me seli në Pejë, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer fakultetin e bujqësisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i R.së Kosovës, më parë i pa dënuar;

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot No
DPK/DMP 03-4150/12	
Nr. llog. Broj sarranica Nr. pages	Data Datum Date
02 14.11.2012	

ËSHTË PËRGJEGJËS

Ngase në cilësi të zyrtarit të lartë publik, Kryeshf Ekzekutiv pranë Kompanisë Rajonale të Ujitjes, Sh.A. "Drini i Bardhë" në Pejë, nuk e ka përbushur obligimin e tij ligjor, për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012, në afatin e përcaktuar me ligj deri me 31 mars 2011.

-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par.1 pika 1.2 dhe nenit 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-150, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Andaj në bazë te dispozitave të theksuara ligjore, e në vështrim të nenit 17 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.04/L-150, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në vështrim të nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet,

D E N O H E T

ME DËNIM NË TË HOLLA në shumë prej 500.(pesëqind) €, të cilin është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të shndërrimit në dënim burgu duke llogaritur 15€ për një ditë.

Obligohet i pandehuri që në emer të shpenzimeve gjyqësore të paguaj gjykatës shumë nën prej 5 €, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimin.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, Dep.i Parandalimit, Prishtinë, me kërkesën Nr.01-2534-12 të dt.13.07.2012, ka kërkuar nga Gjykata zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Milazim Shatri nga fsh.Tomoc, K-Istog, për kundërvajtje nga neni 6 par.1 pika 1.2 dhe nenit 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-150 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

1809

I pandehuri në mbrojtjen e tij, ka deklaruar se pranë KRU "Drini Bardhë" Sh.A, me seli në Pejë, është i përcaktuar në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të kompanisë që nga muaji maj 2007, dhe sa i për këtë deklarament të pasurisë përfundimisht me vitin 2011 i ka kryer obligimet brenda afatit ligjor, ndërsa lidhur me deklarament të pasurisë për vitin 2012 gjithashtu e ka të kryer një obligim të tillë por me vonesë dhe atë me dt.14.08.2012, duke i prezantuar gjykatës në shikim vërtetimin mbi dorëzimin e formularit. Ka njoftuar gjykatën se nuk ka qenë në dijeni për datën e dorëzimit të formularit dhe pas njoftimit me shkrim lidhur me mos deklarament të pasurisë e ka bërë një gjë të tillë, duke kërkuar nga gjykata që me rastin e vendosjes ta ketë parasysh se mos deklarament i pasurisë brenda afatit ligjorë nuk ishte për ndonjë qëllim të caktuar, mirëpo si pasojë e mos dijës së datës së dorëzimit të formularit, duke kërkuar nga gjykata që me rastin vendosjes ta ketë parasysh deklarament të tij.

Gjykata nga mbrojtja e të pandehurit, dhe pas vlerësimit të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse si dhe shkresave tjera të lëndës, e duke pasur parasysh obligimin e zyrtarit të lartë për deklarament të rregullt vjetor të pasurisë në pajtim me nenin 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-150, ka gjetur se i pandehuri është përgjegjës për kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, e për të cilën e shpalli përgjegjës dhe e denoi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Mbrojtjes së të pandehurit gjykata nuk ia fali besimin me që i njëjti kishte për qëllim shmangien nga përgjegjësia kundërvajtëse.

Gjatë matjes së dënimit u muarrën parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, ku si rrethana lehtësuese vlerësohen sjellja e të pandehurit në gjykatë, pranimi i përgjegjësisë kundërvajtëse, fakti se i pandehuri tani e ka të kryer obligimin e tij ligjor për Deklarament dhe Prejardhjen e Pasurisë, e të gjitha këto krijuan bindjen tek gjykata se me dënimin e shqiptuar në masë të mjaftueshme do të ndikoj pozitivisht në ndërgjegjësimin e tij në të ardhmen që të mos përsërisë kundërvajtje të tillë.

Vendimi mbi pagesën e shpenzimeve gjyqësore, u muar në kuptim të nenit 109 par.1 pika 6 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Andaj nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

NGA GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PEJË,

Regj.Nr.5-9200/12, me dt.08.10.2012



KËSHILLA JURIDIKE:

Këtij aktvendimi mund të bëhet ankesë,
Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë,
në afatin prej 8 ditëve nga dita e dorëzimit të
këtij aktvendimi në përmes të kësaj Gjykate.